

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO - SYRI TV/ Abuzimet me konçensionet PPP, gati gjysma e pagesave nën hetim
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919567/syri-tv-abuzimet-me-koncensionet-ppp-gati-gjysma-e-pagesave-nen-hetim/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:49:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:37:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	41c09e69feae466a86726fe4287b90b1b10b9bb53a0ad6e6b1a00cd702c83e6f
TEKSTI	03c3f3cc5d5e0934be30bd1ff5b70f870ed5e5e0816c2fe02b9fde7f37da4e63
PAMJA	f781d182036c06fa4605f11cc3cf7966b89b2ffb19cfa40bb237db70d027c734

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bc4905477ad85246a4bb443f11de03190e93b541fe19a19f612184b99ffc8771
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728bdbf8bf8d029d400ef1ab927ee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bc4905477ad85246a4bb443f11de03190e93b541fe19a19f612184b99ffc8771>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEÇA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'




FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

LAJMI I FUNDIT

LIVE - 'Rama jepe dorëheqjen', protesta e 120-të, qytetarët nisin marshimin në rrugët e Tiranës



më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s'menaxhon dot më



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



SYRI TV/ Abuzimet me koncesionet PPP, gati gjysma e pagesave nën hetim

20:37, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



98 miliardë lekë janë paguar nga buxheti i shtetit për 12 kontrata koncesionare në periudhën 2017-2025. Shifra përfshin koncesione në shëndetësi, infrastrukturë dhe menaxhimin e mbetjeve. Pagesat më të larta janë kryer për Rrugën e Arbrit, sterilizimin, skanimin dhe inceneratorin e Tiranës. Ndërkohë, gjashtë prej këtyre kontratave janë përfshirë në hetime të SPAK. Të dhënat e Ministrisë së Financave ngrenë gjithashtu shqetësime për monitorimin dhe kontrollin e kontratave, ndërsa pagesat e vitit 2025 arritën në nivelin më të lartë që prej nisjes së raportimit.

SYRI TV

Për periudhën 2017-2025 buxheti i shtetit ka paguar në total 98 miliardë lekë, ose rreth 1 miliard euro, për 12 kontrata koncesionare. Në vitin 2015 u dhanë koncesioni i sterilizimit dhe ai i check-up. Në 2016 u miratua koncesioni i dializës, ndërsa në 2019 ai i laboratorëve, të gjitha kontrata në sektorin e shëndetësisë. Në të njëjtën periudhë nisi edhe praktika e koncesioneve për trajtimin e mbetjeve. Kontrata për inceneratorin e Elbasanit u dha në vitin 2015, më pas u shtua ajo e Fierit në 2017 dhe në vitin 2019 i Tiranës. Në vitin 2017 u dha me koncesion mirëmbajtja e rrugës Milot-Morinë, ndërsa në 2018 u miratua kontrata për Rrugën e Arbrit, teksa u rishikua gjithashtu koncesioni i skanimit. Të gjitha këto kontrata përfituan pagesa të drejtpërdrejta nga buxheti i shtetit.

Një pjesë e konsiderueshme e kontratave ka rezultuar joeficiente në kosto, ndërsa disa prej tyre janë tashmë objekt hetimi zyrtar nga SPAK. Të dhënat e Ministrisë së Financave për buxhetet faktike të periudhës 2017-2025, të përpunuara nga "Monitor", tregojnë se buxheti i shtetit për 12 kontratat koncesionare, ka paguar në total 98 miliardë lekë.

Pagesa më e lartë është kryer për Rrugën e Arbrit, me 22.6 miliardë lekë. Më pas renditet koncesioni i sterilizimit, me 14.8 miliardë lekë, skanimi me 13.7 miliardë lekë dhe Inceneratori i Tiranës me 8.4 miliardë lekë. Nga 12 koncesionet e

inancuara nga buxheu, për gjashtë prej tyre – tre inceneratorët, check-up, sterilizimi dhe laboratorët – është hapur një hetim zyrtar ose kanë nisur procedurat nga SPAK, me akuza që përfshijnë korrupsionin, shpërdorimin e detyrës dhe pastrimin e parave. Për këto gjashtë kontrata, buxheti i shtetit ka paguar gjatë periudhës 2017-2025 gjithsej 44.4 miliardë lekë, ose rreth 460 milionë euro. Nga totali, rreth 15 miliardë lekë janë paguar për projektet e inceneratorëve. Ndërkohë, rreth 29.6 miliardë lekë janë paguar për tre koncesionet e shëndetësisë që janë nën hetim nga SPAK-u. Edhe vetë Financat kanë shprehur shqetësimin se kontratat koncesionare nuk po kontrollohen dhe as monitorohen në respekt të detyrimeve ligjore dhe marrëveshjeve ndërmjet shtetit dhe privatit, që janë instrumente të detyrueshme. Pagesat faktike për vitin 2025, në total arriten në 13.35 miliardë lekë, me rritje minimale vjetore prej 0.5%, duke shënuar nivelin më të lartë historik që prej vitit 2017, kur ka filluar raportimi.

Inceneratorët mbeten ndër koncesionet më të debatuar në vend, për shkak të shkeljeve dhe abuzimeve të konstatuara gjatë hetimeve të SPAK. Tre kontratat janë vendosur nën masa bllokuese ose sekuestroje, ndërsa hetimet kanë ngritur pikëpyetje të forta mbi mënyrën e dhënies së tyre, përdorimin e fondeve publike dhe realizimin faktik të investimeve. Gjithashtu hetimet për tre inceneratorët nxorën më qartë në pah se kontratat nuk sollën përmirësimin e pritshëm në menaxhimin e mbetjeve, ndërsa kostot për buxhetin mbetën të larta. Sipas hetimeve të SPAK, shkeljet nisën që në procedurat e dhënies së koncesioneve dhe vijuan me falsifikimin e dokumenteve të pronësisë, krijimin e kompanive fiktive, faturime të rreme dhe pagesa për punime të parealizuar. Hetimi evidentoi gjithashtu përdorimin e skemave fiktive të pagesave për të fshehur origjinën dhe destinacionin e shumave monetare, si dhe faturime të rreme që dyshohet se janë përdorur për të fryrë shpenzimet dhe për të ulur detyrimet tatimore.

Sot, gati gjysma e shumës së dhënë për koncesionet, është nën hetim, ndërsa nuk ka përgjegjës për arkitektët e këtij abuzimi masiv, dëmet që i sollën ekonomisë dhe shpërdorimin e parave të taksapaguesve, në të ashtuquajturat skema të partneritetit publik privat.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Përfundojnë fjalimet para Kryeministrit, qytetarët vijojnë marshimin në Tiranë: Rama jep dorëheqjen



VIDEO/ Qytetari: Rama asnjë takim të nivelit të lartë në OKB, por vetëm foli keq për popullin e tij



'Më 3 tetor diaspora protestë në Bruksel'/ Qytetari kërkesë për PE-në: Ndaloni takimet me Ramën

© SYRI.net

'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

TË NGJASHME



'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Skandal i SHISH/ Muçollari: Rama do që krimi të mos merret vesh, jo që të mos ndodhë



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



Protesta e 120-të kundër Ramës, qytetarët marshojnë nga Sheshi Skënderbej drejt Kryeministrit



VIDEO/ Fjalimet në OKB, Maliqi: Rama foli për veten e tij, Kurti kishte në fokus çështjet e Kosovës



Droga po shkon tek fëmijët tanë!



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.